



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E QYTETIT
KORÇË

KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORÇË

V E N D I M

Nr. /// datë 26/11-2007

PËR

DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE FAMILJEVE TË DËMTUARA SI REZULTAT I NJË SHPËRTHIMI DHE NJË DJEGJE BANESE NGA ZJARRI

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Korçës ne mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi morri në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sek.i Sportit dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike, “ Për dhenien e ndihmës financiare familjeve të dëmtuara si rezultat i një shpërthimi dhe një djegje banese nga zjarri. “, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.206 datë 26.03.1998, i ndryshuar, “ Për kriteret për pjesmarrjen e shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqsish”, Ligjin nr. 8652 datë 31.07.2000,” Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma dh, Ligjit nr. 8399 datë 09.09.1998 “Për buxhetin lokal”neni 6, Udhezimi nr.2 datë 17.01.2007, i Ministrisë së Financave, “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007”, V.K.të Bashkisë nr. 2, datë 02.02.2007, “Për miratimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007” dhe pas diskutimit të këshilltarëve:

V E N D O S I

- 1- Të ndihmohet familja e qytetarit Skënder Kaçe të cilit ju dëmtua banesa dhe disa orendi e paisje shtëpiake, si rezultat i një shpërthimi të bolierit (dushi elektrik), e ndodhur në lagjen nr. 9, rruga “ Midhi Kostani, “ pallati “ Çajupi “ hyrja d/3. Masa e ndihmës për dëmet në orendi e paisje dhe anën ndërtimore do të jetë si më poshtë:

- Për dëmin ne orendi e paisje 4(persona) x 20.000 = 80.000 lek.
- Për dëmin në anën ndërtimore 143.200 lek.

Shuma gjithsej

223.200 lek

- 2- Të ndihmohet familja e qytetarit Viktor Hoxhallari, i cili u dëmtua rëndë nga zjarri, në paisje dhe orendi shtëpiake, banues në Rrugën e Mborjes, (ish Vila

e Partisë). Masa e ndihmës për dëmin në paisje dhe orendi do të jetë si më poshtë:

- Për dëmin në orendi dhe paisje, $3(\text{persona}) \times 20.000 = 60.000 \text{ lek.}$

3 - Masa e ndihmës për të dyja rastet do të jetë 283.200 lek.

4 - Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë :

Pakësohet 00 04980 05 Art. 6091100 - 283.200

Shtohet 00 01110 05 Art. 6061041 +283.200

5 - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sek. Sportit dhe Emergj. Civile dhe Drejtoria Juridike.

6 - Ky vendim hyn në fuqi me njëherë.

K R Y E T A R I

Rajmonda NASE
Rajmonda NASE